



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Primljeno: 08.01.2025		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-1148		



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 qershor 2008, Rregullores MF - NR – 04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 16.12.2024, Drejtori/ja e DKRS –së merr këtë :

VENDIM PËR SHPALLJE TË THIRRJES PUBLIKE PËR OJQ

I

Për shpalljen e Thirrjes Publike për mbeshetje financiare publike për projekte/programme të Organizatave Joqeveritare në fushen e Kulturës dhe Sportit për organizimin e estës së 17 Shkurt, Dita e Pavarësisë së Kosovës , KOSOVA 17

II

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF - NR – 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti I KOMUNËS (DKRS) kodi ekonomik 85003 SUBVENCIONE të vitit 2025 në kuadër të Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

III

1. Mjetet e përmendura në nenin II do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

IV

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:

1. Teksti i thirrjes publike ;
2. Udhëzimet për aplikantët ;

3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VII

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve.

2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.

3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport .

VIII

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Lipjan 08.01.2025

Anila Reçica Llugiqi

Drejtoreshë e DKRS-së

